



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 23.19.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË TË AUTORITETIT
RREGULLATIV TË HEKURUDHAVE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti mbështetur nga Veton Misiri (Udhëheqës i ekipit) dhe Zahir Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
5 Sistemi i auditimit të brendshëm.....	18
6 Konkluzioni i përgjithshëm	19
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	20
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	22

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PVF-të) për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH - tash e tutje). Unë do të doja të falënderoja Kryetarin e Bordit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë fokusohej në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF);
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në Shtojcën I - Opinioni i Auditimit. Kjo shtojcë shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Opinionin e AP-së është:

Pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë (SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar).

Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

ARH ka treguar progres në menaxhimin financiar dhe kontrollin në krahasim me vitin e kaluar. Menaxhmenti ka arritur të ndërtoj një sistem adekuat të kontrollit të brendshëm i cili ka gjeturë zbatim pothuajse në të gjitha fushat e rëndësishme, në përjashtim të fushës së ndërlidhur me menaxhimin e buxhetit, kërkesave për raportim të jashtëm dhe menaxhimit të pasurisë. Këto dhe mangësitë e tjera janë të shpjeguara më në detaje më poshtë.

Ne kemi konsideruar përgjigjet e menaxhmentit ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011. Përgjigjet e menaxhmentit për rekomandimet e dhëna në këtë raport janë të përmbledhur në Shtojcën II. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se ARH ka adresuar rekomandimet e ZAP në lidhje me auditimin e vitit 2011.

Në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit si dhe Auditimin e Brendshëm do të njoftoheni në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Bordit janë si në vijim:

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

- Të rishqyrtoj proceset ekzistuese buxhetore për të siguruar përmirësimin e planifikimit dhe dinamikën e realizimit të buxhetit për kategorinë mallra dhe shërbime. Si pjesë e këtij procesi, duhet të siguroj që dinamika e rrjedhës së parasë respektohet dhe prioritet i ipet shpenzimit të buxhetit për qëllimet e aprovuara fillimisht;
- Të siguroj që ka ndërmarr masat konkrete për përgatitjen e raportit vjetor të performancës për të siguruar që objektivat e punës realizohen në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të shqyrtoj mundësin e zhvillimit të procedurave të prokurimit lidhur me shërbimet e telefonisë mobile në mënyrë që të siguroj shërbime efikase me çmime më të favorshme;
- Paraprakisht, të siguroj që ka buxhet të mjaftueshëm dhe më pas të hyj në obligime, njëherit të siguroj se faturat paguhen brenda 30 ditëve nga pranimi i tyre, dhe
- Të kryej inventarizimin e pasurisë në fundvit sipas kërkesës në UA nr 21/2009 me qëllim që të vërtetohet gjendja e gjithë pasurisë në kohën e inventarizimit.

Kryetari është pajtuar me të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do ti adresojë rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e ARH-së të përgatis PVF-të sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. ZAP është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për ARH-në. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme. Kjo është bërë, për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të nëntë mujorit aty ku ishte e rëndësishme. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave vjetore financiare përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”.

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur se:

- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF);
- PVF janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura gjatë auditimit të 9 mujorit në lidhje me kornizën raportuese në memon tonë të datës 16/12/2012 janë adresuar nga Menaxhmenti (për më shumë shih nënkaptullin Kërkesat e Raportimit).

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Kemi analizuar cilësinë e informatave të prezantuara në PVF. Ne vlerësojmë se informatat e prezantuara në PVF-të 2012 janë të plota dhe të sakta.

Përshkrimi

ARH ka përgatitur draft pasqyrat financiare brenda afatit ligjor 31 janar 2013. Ne kemi rishikuar pasqyrat financiare me kohë, me qëllim që të adresojmë vërejtjet eventuale si dhe dhënien e mundësisë së korrigjimit të tyre brenda afatit për korrigjim.

Pasqyrat financiare finale nuk kanë pësuar ndryshime në krahasim me draft pasqyrat. ARH nuk ka pasur nevojë për korrigjime eventuale të draft Pasqyrave Financiare Vjetore.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, kur draft PVF-të e dorëzuar në Qeveri mund të konsiderohet e vërtetë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Opinioni i Auditimit

Pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë (SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar).

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

ARH i ka adresuar rekomandimet e ZAP në lidhje me Auditimin e PVF 2011. Kjo tregon që menaxhmenti i ARH -së ka treguar përkushtim për menaxhim më të mirë financiar dhe kontroll.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të vitit 2011 të ARH-së ka rezultuar në pesë (5) rekomandime kryesore. ARH ka përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar se rekomandimet do të adresohen.

Në fund të auditimit tonë për 2012, të 5 (pesë) rekomandimet janë adresuar plotësisht. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky mund, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më ulët.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

ARH ka shpenzuar buxhetin final në masë prej 93%. Realizimi i buxhetit për të gjitha kategoritë ekonomike është në nivel të knaqshëm, përpos shpenzimeve në kategorinë e pagave dhe mediteve ku buxheti nuk është shpenzuar më shumë se 87%. Pavarësishtë kësaj, obligimet e mbetura në fund të vitit 2012 janë tregues që planifikimi dhe realizimi i buxhetit ka nevoj për përmirësim.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për ARH-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizim
Burimet e Fondeve:	211,510	242,962	225,420	147,037	112,115
Granti i Qeverisë-Buxheti	211,510	242,962	225,420	147,037	112,115

Buxheti fillestarë i ARH –së për vitin 2012 ishte në vlerë 211,510€ ndërsa me rishikim të buxhetit është rritur në 242,962€. Buxheti final për vitin 2012 ishte shpenzuar 225,420€ apo 93% të buxhetit final.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	211,510	242,962	225,420	147,037	112,116
Pagat dhe Mëditjet	101,497	121,449	106,205	73,515	34,120
Mallrat dhe Shërbimet	76,013	95,513	95,500	68,435	77,914
Komunalitë	14,000	6,000	5,860	5,087	82
Shpenzimet kapitale	20,000	20,000	17,855		

Tabela nr. 2 tregon shpenzimet dhe ndryshimet e buxhetit nëpër kategori. Me rishikim, buxheti për kategorin e pagave dhe medijtjeve është rritur për 19,500€, buxheti në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është rritur për 19,592€, ndërsa kategoria për shërbime komunale është zvogëluar për 8,000€.

Rritja e buxhetit në kategorinë e pagave dhe medijtjeve është bërë për plotësimin e katër pozitive të lira të aprovuara dhe plotësimit të pozitës së anëtarit të bordit.

Shpenzimi i buxhetit në të gjitha kategoritë është në nivel të knaqshëm, në përjashtim të kategorisë për paga dhe medijtje, ku buxheti ishte shpenzuar 87%. Vonesat në realizimin e proceseve të rekrutimit të stafit ishin shkaktarë të mos realizimit të buxhetit në këtë kategori.

Buxheti final për kategorinë mallra dhe shërbime ishte shpenzuar pothuajse 100%.

Rekomandim

1. Çështja - Planifikimi dhe realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve- Prioritet -i rëndësishëm

E gjetura Shpenzimi i buxhetit për kategorinë mallra dhe shërbime në masë prej 100% është performanc e mirë, megjithatë ARH në fund të vitit kishte obligime në vlerë 10,319€. Këto obligime kishin të bënin me mallra dhe shërbime duke përfshirë faturat për qiratë e objektit në tre muajt e fundit të vitit 2012 në vlerë totale prej 4,875€.

Më tutje edhe dinamika e shpenzimeve për këtë kategori nuk ishte sipas planit të rrjedhës së parasë të përgatiturë nga ARH.

Rreziku Mos pagesa e qirasë së objektit është tregues që buxheti mund të jetë shpenzuar për qëllimet të cilat nuk janë përcaktuar në fillim. Mos pagesa e qirasë rrezikon humbjen e besueshmërisë të furnitorëve ndaj institucioneve publike.

Rekomandimi 1 Të rishqyrtoj proceset ekzistuese buxhetore për të siguruar përmirësimin e planifikimit dhe dinamikën e realizimit të buxhetit për kategorinë mallra dhe shërbime. Si pjesë e këtij procesi, duhet të siguroj që dinamika e rrjedhës së parasë respektohet dhe prioritetet i ipet shpenzimit të buxhetit për qëllimet e aprovuara fillimishtë.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

ARH në përgjithësi i ka përmbushur kërkesat e raportimit, përpos raporteve të vetëvlerësimit siç kërkohet me kërkesat e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Përshkrim

Gjatë vitit 2012 ARH ka përmbushur përgjegjësitë për raportim të jashtëm si në vijim:

- Ka përgatitur kërkesat buxhetore;
- Ka përgatitur dhe dorëzuar raportet tremujore në MF;
- Ka përgatitur dhe ka dorëzuar me kohë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit për vitin 2012 është përgatitur dhe dorëzuar me kohë në AQP;
- Janë përgatitur dhe dorëzuar në MF në vazhdimësi raportet mbi borxhet; dhe
- Është përgatitur dhe është dorëzuar në ZAP plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit; dhe
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit;

ARH nuk ka përmbushur përgjegjësitë për raportim të jashtëm si në vijim:

- Raportin vjetor të performancës për vitin 2011.

Rekomandimi

2. Çështja - Raporti i performancës për vitin 2011-Prioritet -i Rëndësishëm

E gjetura Çdo organizatë buxhetore është e obliguar që të përgatis dhe të dorëzoj tek organet përkatëse raportin vjetor të performancës për çdo vit fiskal. ARH për vitin 2011 nuk kishte përgatitur raportin vjetor të performances për vitin 2011.

Rreziku Mos përgatitja e këtij raporti ka pasur për pasoj mungesën e llogaridhënies dhe transparencës ndaj Kuvendit si dhe mungesën e informatave lidhur me punën dhe shërbimet e ofruara dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2011 për të gjitha palët e interesit.

Rekomandimi 2 Të siguroj që ka ndërmarr masat konkrete për përgatitjen e raportit vjetore të performancës për 2012 me qëllim të përmbushjes së kërkesave ligjore.

4.4 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm

ARH i kupton nevojat e kontrolleve të forta të sistemeve në këtë fushë, prandaj ka ushtruar kontrolle përkatëse të kryerjes së prokurimeve në pajtim me LPP-në. Megjithatë, ARH ende nuk ka vendosur kontrolle adekuate në menaxhimin e pasurisë dhe rishikimit të shpenzimeve të telefonisë për të siguruar shërbime efikase me çmime më të ulta.

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

ARH ka përgatitur planin e prokurimit për vitin 2012. Për vitin 2012, ARH ka lidhur marrëveshje me AQP-në që procedurat e prokurimit të udhëhiqen nga zyrtari i AQP-së. Me planin e prokurimit janë planifikuar 18 kontrata në vlerë prej 44,440€ prej të cilave 8 (tetë) kontrata për furnizime në vlerë prej 28,340€ dhe 10 kontrata për shërbime në vlerë prej 16,100€.

Për periudhën 2012, ARH ka lidhur 4 (katër) kontrata në vlerë prej 20,505€. Prej tyre një kontratë është lidhur në vlerë prej 17,855€ për blerjen e një veture ndërsa tri të tjera janë kuotime çmimesh me vlerë minimale në vlerë prej 2,650€.

Rekomandimi

3. Çështja - Plani i prokurimit - Prioriteti - tjera

- E gjetura** ARH ka realizuar vetëm katër kontrata prej 18 kontratave të planifikuara.
- Rreziku** Mos realizimi i kontratave është tregues që ky plan nuk është përgatitur duke pasur parasysh nevojat reale të ARH-së.
- Rekomandimi 3** Plani i prokurimit duhet të përgatitet duke pasur për bazë nevojat reale të institucionit.

4.4.2 Shpenzimet tjera

Përshkrim

Nga shpenzimet e tjera ne kemi testuar shpenzimet e ndërlidhura me udhëtime jashtë vendit, shpenzimet e telefonit dhe shërbimet komunale. Shpenzimet për udhëtime jashtë vendit marrin pjesë me 28% në totalin e shpenzimeve në kategorinë për mallra dhe shërbime.

Rekomandimi

4. Çështja - Furnizim me mbushje të telefonave mobil pa kontratë - Prioriteti - i rëndësishëm

- E gjetura** Sipas rishikimeve analitike shpenzimet e telefonit për vitin 2012 janë 10,448€, prej të cilave 6500€ janë shpenzime për telefonin mobile, ndërsa 3,948€ për telefoninë fikse . Limitet për shpenzime të telefonis mobile janë përcaktuar përmes Udhëzimit Administrativ nr 01/2010 të datës 18.08.2010. Furnizimi me mbushje të telefonave mobil është bërë nga një operator ekonomik dhe pa ndonjë kontratë përmes kartelave grithëse.
- Rreziku** Duke pasur parasysh se në Kosovë tani operojnë disa operator ekonomik që ofrojnë shërbime të ndryshme dhe me çmime të favorshme, mënyra aktuale e furnizimit me mbushje të telefonave nuk i siguron ARH-së shërbime efektive, efikase dhe ekonomike.
- Rekomandimi 4** Të shqyrtoj mundësin e zhvillimit të procedurave të prokurimit lidhur me shërbimet e telefonisë mobile në mënyrë që të siguroj shërbime efikase me çmime më të favorshme.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet ekzekutohen përmes sistemit të MAP-it, sistem i centralizuar. Sistemi i pagave është një sistem ku ARH ka operuar me një numër kontrollesh lokale si në vijim:

- mbajtjen dhe azhurnimin e rregullt të dosjeve të të punësuarve nga Drejtori Administratës i ngarkuar njëkohësisht edhe me Personelin; dhe
- sektori i financave është njoftuar rregullisht dhe me kohë lidhur me ndryshimet në paga dhe mëditje.

Buxheti fillestar në kategorinë Paga dhe Meditje ishte 101,497€ ndërsa me rishikim Buxheti i ARH-së për këtë kategori është rritur në vlerë 121,449€. Gjatë vitit 2012 për paga dhe meditje janë shpenzuar 106,205€ përkatësisht 87%.

Për këtë periudhë, ARH ka pasur gjithsej 17 të punësuar duke përfshirë edhe katër anëtar të bordit. Numri i pozitive të lejuara me buxhetin fillestar ishte 12 pozita ndërsa me rishikim janë aprovuar edhe pesë (5) pozita shtesë. Deri në fund të vitit 2012, ARH ka arritur të plotësoj pozitat e aprovuara me rishikim të buxhetit. Këto pozita ishin plotësuar në tre mujorin e fundit të vitit dhe këto vonesa kanë ndikuar në realizimin jo të plotë të buxhetit për këtë kategori.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm

ARH ka dizajnuar një sistem të mirë për regjistrimin, mirëmbajtjen dhe raportimin e pasurive kapitale (mbi 1,000€), si dhe për pasuritë jo-kapitale (nën 1,000€). Megjithatë, për vitin 2012 nuk ka finalizuar inventarizimin e pasurisë.

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Në bazë të Udhëzimit Administrativ IA 21/2009 organizatat buxhetore janë të obliguara të themelojnë çdo vit komisionin për vlerësimin e pasurisë dhe inventarizimin e pasurisë.

Pasuritë kapitale (mbi 1,000€) në PVF janë shpalosur në vlerë 30,092€. Pasuritë jo-kapitale (nën 1,000€) janë shpalosur në PVF në vlerë 32,052€.

Ne kemi testuar nëse pasurit e blera në vitin 2012 janë regjistruar në regjistrin kontabël – SIMFK, nëse është llogaritur zhvlerësimi i pasurisë sipas dhe kemi testuar se a janë të numërtuar të gjitha pasuritë me barkode.

Rekomandim

5. Çështja - Kryerja e inventarizimit të pasurisë me vonesë-Prioritet –i Rëndësishëm

E gjetura Sipas UA nr.21/2009, Organizata buxhetore është e obliguar që një herë në vit para përfundimit të çdo viti fiskal të bëjë numërimin fizik apo inventarizimin e gjithë pasurive që janë në posedimin e saj.

E gjetura Për vitin 2012 ARH nuk kishte arritur të bëjë inventarizimin e pasurisë. ARH kishte formuar komisionin e inventarizimit të pasurisë me datën 08 Maj 2013. Mirëpo deri në përfundim të auditimit ne nuk na është ofruar ndonjë dëshmi për finalizimin e inventarizimit.

Rreziku Mos kryerja e inventarizimit në përfundim të vitit fiskal dhe mos azhurnimi i evidencave shton rrezikun që ARH të mos ketë informata të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim. Gjithashtu kjo mund të ndikoj në përmbajtjen e raportimit të brendshëm dhe atij të jashtëm.

Rekomandimi 5 Të bëhet inventarizimi i pasurisë në fundvit sipas kërkesës në UA nr 21/2009 me qëllim që të vërtetohet gjendja e gjithë pasurisë në ditën e inventarizimit.

4.6 Menaxhimi i automjeteve

Konkluzion i përgjithshëm për Menaxhimin e Automjeteve

ARH ka vendosur në funksion kontrolle adekuate lidhur me menaxhimin e automjeteve zyrtare

Përshkrim

Ne kemi rishikuar se si janë menaxhuar automjetet dhe nëse është zbatuar UA nr.03/2008 për përdorimin e automjeteve zyrtare. ARH posedon një automjet i cili është blerë në vitin 2012. Shpenzimet e karburanteve për vitin 2012 ishin në vlerë prej 1,395€.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm

ARH ka prezantuar obligimet e papaguara në PVF. Mirëpo, jo gjithmon ishin paguar brenda afatit të përcaktuar ligjorë.

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2012 ishte në vlerë prej 10,319€. Këto detyrime kishin të bënin me faturat e pranuar në fund të vitit dhe janë bartur për t'u paguar në vitin 2013. Faturat lidhur me këto obligime kishin të bënin me obligimet e tre mujorit të fundit të 2012 dhe kishin të bënin lidhur me mallrat dhe shërbimet.

Më tutje, edhe në fund vitit 2011, ARH-kishte pasur fatura të papaguara në vlerë prej 9,319€ të cilat janë paguar me buxhetin e vitit 2012..

Rekomandimet

6. Çështja - Obligimet e papaguara - Prioriteti - i rëndesishem

E gjetura ARH nuk ka qenë efikase në shlyerjen e obligimeve. ARH në fund të vitit ka shpalosur obligime në vlerë prej 10,319€. Këto obligime janë shlyer në janar të vitit 2013 nga buxheti i vitit të njëjtë . Obligimet ishin relativisht të larta kur mirret parasysh që vetëm fatura e qirasë për tre muajt e fundit të vitit 2012 arrin vlerën prej 4,875€. Kjo njëjtë ka ndodhur edhe me obligimet e vitit 2011 të cilat janë paguar me buxhetin e vitit 2012. Këto mangësi janë cekur edhe tek kapitulli 4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.

Rreziku Mos planifikimi i duhur si dhe mos kryerja e pagesave me kohë ka ndikuar që ARH të ballafaqohet me vështërsi financiare nga viti në vit. Këto obligime vazhdimisht kanë ngarkuar buxhetin e vitit pasues si dhe kishte ndikuar që ARH vazhdimisht të hyj në obligime të reja pa siguruar buxhet për financimin e tyre.

Rekomandimi 6 Paraprakisht, të siguroj që ka buxhet të mjaftueshëm dhe më pas të hyj në obligime, njëherit të siguroj se faturat paguhen brenda 30 ditëve nga pranimi i tyre..

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sipas U/A nr. 23/2009, ARH nuk i plotëson kriteret për themelimin e Njesisë së Aditimit të Brendshëm (më tutje NjAB). Megjithatë, udhëzimi i lartëpërmendur rregullon rastet kur organizatat nuk i plotësojnë kriteret për auditim të brendshëm dhe ofron mënyra tjera të sigurimit të këtyre shërbimeve.

Në auditimin e vitit 2011, ne kishim rekomanduar ARH të marrë në konsideratë lidhjen e një marrëveshje me ndonjë institucion të pavarur për shfrytëzimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm.

ARH gjatë vitit 2012 ka pranuar shërbimet e auditimit të brendshëm nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave. Ky departament ka mbuluar menaxhimin e buxhetit, shpenzimeve, personelit dhe menaxhimin e pasurisë dhe ka dhënë rekomandime konkrete dhe të dobishme për menaxhmentin e ARH-së.

Menaxhmenti duhet të siguroj që ka ndërmarr masa konkrete për adresimin e rekomandimeve të AB-së me qëllim të përmirësimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në ARH

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të Sistemit të Auditimit të Brendshëm.

ARH në përgjithësi ka arritur të dizajnoj një sistem adekuat të kontrollit të brendshëm për të siguruar bazë për përdorim efektiv dhe efikas të parasë publike dhe për të ofruar informata të cilësisë së mirë, të cilat do të mbështetnin vendimmarrjet e menaxhmentit.

Sistemi aktual kontrollit deri në një shkallë ka siguruar që informatat klasifikohen, regjistrohen, mirëmbahen dhe raportohen sipas kërkesave ligjore.

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”.

Më tutje, mos përgatitja e raportit të performancës për vitin 2011 dhe mos kryerja e inventarizimit i ka pamundësuar menaxhmentit të ARH-së që të ketë një pasqyrim të drejtë dhe informata të plota në lidhje me funksionimin e kontrolleve të brendshme dhe mënyrën se si menaxhohen proceset brenda institucionit.

Këto dhe mangësit e prezantuara në këtë raport dhe në raportin e AB-së të MF-së janë tregues që sistemi kontrollit të brendshëm në ARH ka nevojë të rishikohet me qëllim të sigurimit që objektivat e organizatës janë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriktionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhena	Rekomandimet plotesisht te adresuara	Rekomandimet pjeserisht te adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Blerjet tjera	Ka rishikuar delegimin e përgjegjësive dhe mënyrën e kompensimit të marrëveshjeve ndër institucionale.	PO		
2. Pasuria	Mundësinë e çertifikimit të ndonjë zyrtari të brendshëm si zyrtar i pasurisë, ose të arrihet marrëveshje bashkëpunimi me ndonjë institucion të pavarur për shërbimet e përbashkëta rreth pasurisë.	PO		
3.Kontrolli Menaxherial	3.1 Ka shtuar aktivitetet e kontrollit në fushat e mbuluara nga përgjegjësitet e deleguara; 3.2 Lejimet e pushimeve pa pagesë të kryhen në pajtim me kërkesat ligjore dhe duke marrë parasysh rëndësinë e vendit të punës; dhe 3.3 Të përshtaten kontrat e punës të personelit me vendimet e bordit	PO		
4. Auditimi	Ka diskutuar çështjen e auditimit të brendshëm me komisionet përkatëse në Kuvendin e Kosovës.	PO		

5. Konkluzioni përgjithshëm	5.1 Ka rishikuar praktikat aktuale lidhur me delegimin e përgjegjesive për kryerjen e shërbimeve administrativo/financiare; dhe 5.2 Ka iniciuar një plan për trajnimin e zyrtarëve lidhur me çështjet administrative dhe financiare	PO		
-----------------------------	--	----	--	--